



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of  
Kosovo**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**



## **TESTI KUALIFIKUES**

### **Udhëzues me rregullat e provimit për kandidatin**

- Siç është përcaktuar me rregullore, testit kualifikues mund t'i nënshtrohen vetëm kandidatët nga lista e publikuar në njoftimin e KPK-së.
  - Testi zgjat 120 minuta dhe ka gjithsej 60 pyetje me tre (3) përgjigje alternative, prej të cilave vetëm një (1) është e saktë.
  - Kandidati duhet të shënojë përgjigjen e tij në pyetjen gjegjëse vetëm në Fletëtestim (i cili do t'i jepet kandidatit bashkë me testin me pyetje). Shënimi duhet të bëhet në katrorin a, b ose c.
1. Gjatë kohëzgjatjes së provimit me shkrim, kandidatit nuk i lejohej:
    - 1.1. asnjë lloj orë dore, çantë dore, letër, dosje, stilolaps, laps, fletore, dokumentet, telefona, kamera, dëgjuese/kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdollojshme;
    - 1.2. asnjë lloj shënimi, ligji, materiali lexues apo material për shkrim (letër e pastër);
    - 1.3. të shënojë ndonjë emër, numër apo çfarëdo shenje tjetër dalluese në ndonjërin prej fletëve të provimit;
    - 1.4. të kopjojë, bisedojë, të këmbejë informata apo çfarëdo komunikimi derisa ndodhet në sallën e provimit;
    - 1.5. të dalë nga salla gjatë kohës së provimit, përpos me leje e komisionit, në raste të domosdoshme, lejohet ta dalin, por vetëm të shoqëruar;
    - 1.6. të hap plikon e provimit derisa të mos jepet udhëzimi për një gjë të tillë nga mbikëqyrësi i sallës dhe
    - 1.7. të vazhdojë të punojë në provim edhe pas dhënies së shenjës nga mbikëqyrësi i sallës për përfundimin e kohës së provimit.
  - Shkelja e rregullave të mësipërme rezulton me shpalljen e provimit të pavlefshëm dhe diskualifikimin e kandidatit.
  - Gjatë kohëzgjatjes së testimit, kandidatët do të marrin udhëzime nga mbikëqyrësi i sallës lidhur me kohën e mbetur për testim, si në vijim: edhe 60 minuta, edhe 30 minuta, edhe 10 minuta edhe 2 minuta dhe, në fund, koha për testim shpallet e mbyllur.

2. Në fund të provimit, kandidati duhet të veprojë sipas rregullave të përcaktuara në rregullore: kandidati do ta vendosë testin e përfunduar në plikon e formatit A-4 dhe do ta mbyll atë, ndërsa në fletëzën e plikos A6 do ta shkruajë emrin, mbiemrin e tij dhe nënshkrimin, si dhe do ta vendosë në plikon A-6, të cilën e mbyllë. Që të gjitha këto veprime do t'i bëjë në prani të komisionit. Këto dy pliko do të lidhen (ngjiten) në mes vete, në të cilat, pas përfundimit të testit në tërësi, komisioni do të shkruajë kodet e njëjta në të dy plikot.